



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 248/7 prot.

Tiranë, më 26. 04.2023

V E N D I M

Nr. 63, datë 26. 04. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 163 Regj., datë 25.10.2022, që i përket ankuesit M. K.¹, kundër S. K., me detyrë Shef i Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, si dhe F. Ç. me detyrë Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, me pretendim diskriminimin për shkak të gjendjes shëndetësore, atë të shëndetit mendor apo psikik dhe gjendjes arsimore/pozitës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *“...Në datë 08.09.2022 në Fakultetin e Drejtësisë ku unë studioj, kam pasur një konflikt verbal me Pedagogun e lëndës “E drejtë penale e posaçme”, K. M. Problematika nuk është provokuar nga ana ime e për këtë arsye, në të njëjtin moment kam telefonuar policinë. Kanë mbërritur në fakultet shërbimet e policisë së Komisarariatit Nr. 2, të Tiranës dhe janë ngjitur së bashku me mua në zyrën e pedagogëve të së Drejtës Penale të Posaçme për të bërë të mundur zgjidhjen e*

¹ Fillimisht ankesa është regjistruar me emrin M. S., por me anë të e-mail-it datë 01.11.2022, ankuesi ka kërkuar ndryshimin e mbiemrit të tij, pas saktësimit të bërë në Zyrën e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. 4, Tiranë. Për këtë ankuesi vuri në dispozicion të KMD-së një kopje të Certifikatës Personale.

çështjes. Më pas shërbimet e patrullës së bashku me E. M. dhe K. M. janë futur në zyrën e zv. Dekanit (E. M.) dhe më kanë njoftuar mua të qëndroj në pritje në korridor.

Më pas, shërbimet e policisë më kanë njoftuar se të dyja palët do shoqëroheni në Komisariatin Nr. 2, të Tiranës për zgjidhje të mëtejshme të konfliktit. Me të mbërritur në Komisariatin Nr. 2, mua më kanë futur direkt në dhomë shoqërimi, ndërsa, K. M. e kanë pritur oficerë të lartë të komisarariatit, për tu ngjitur lart në zyrë.

Jam mbajtur i shoqëruar pa bukë dhe pa ujë për 9 orë me rrallë. Me pas, më kanë dërguar për ekzaminim në psikiatri, kundër vullnetit tim. Të gjitha detajet e dinamikës së ngjarjes janë të pasqyruara edhe në procesverbalet nga ana e policisë për këtë rast, e më pas janë përcjellë prokurorisë për hetim të mëtejshëm.

Në lidhje me këtë çështje, nënvizoj se jam ankuar pranë AMP-së (Agjencia e Mbikëqyrjes Policore) e për këtë gjë, është mbajtur edhe një procesverbal intervistimi me A. P., në detyrën e specialistit të hetimit pranë kësaj drejtorie. Referuar përmbajtjes së procesverbalit, nuk kam vënë në dyshim shoqërimin tim dhe kam dijeni se pse jemi shoqëruar në Komisariat. Mirëpo, kurrsesi nuk kam qenë në dijeni që K. M. është lënë i lirë, kurse unë jam mbajtur në kulmin ekstrem të intervalit kohor të shoqërimit.

Një sjellje e tillë krijon premisa për dyshim se ka diskriminim bazuar në shkakun e mbrojtur të gjendjes arsimore apo shoqërore. Për shkak se, nuk jam në dijeni se çfarë ka diskutuar zv. Dekani i Drejtësisë me policinë dhe me pedagogët, dhe nuk jam në dijeni se pse dhe për çfarë motivi është bërë shoqërimi im i detyrueshëm dhe kundër pëlqimit, në spitalin psikiatrik Nr. 5 të Tiranës.

Për më tepër, në ambientet e shoqërimit K. M., i është mundësuar të bëjë deklaratën i pari ndërkohë personi që ka telefonuar policinë kam qenë unë në cilësinë e viktimës akuzuese.

...Kam ngritur pretendimin e arsyeshëm bazuar në prova se, shoqërimi im i detyrueshëm në psikiatri është bërë me urdhër të zv. Dekanit dhe K. M...

Nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore më është komunikuar se nuk kam të drejtë të bëj kundër-kallëzim, pasi është K. M. i pari ndaj të cilit duhet të merrej deklarata, duke qenë se ai është pedagog dhe është më i privilegjuar në këtë anë. Kur i kam pyetur se pse unë jam mbajtur i shoqëruar kur në realitet unë jam viktimë e këtij konflikti (hipotetikisht) pasi jo më kot e kam telefonuar policinë, ata më kanë konstatuar se, pedagogu gëzon privilegj në bazë të ligjit dhe ka imunitet. Kur kam pyetur pse nuk është mbajtur dhe K. M., 9 orë sikurse unë, ata nuk më kanë dhënë një përgjigje ligjore dhe objektive.

Kjo situatë më vendos në dyshimin e arsyeshëm se ndaj meje është mbajtur jo vetëm një sjellje e paligjshme por edhe diskriminuese nga autoritetet policore, për shkak se nuk e kam kuptuar se mbi ç'baza unë jam mbajtur i shoqëruar, kurse K. M. jo.

Pra, unë nuk kam qenë në dijeni të faktit se, në shoqërimin e të dy palëve, K. M. nuk është mbajtur në të njëjtat kushte. Aq më tepër, shoqërimi im në psikiatri, pas 9 orësh shoqërim dhe indiciet nga e-mail-et që K. M. ka përdorur në e-mail-et që më ka nisur, të cituara më lart, e përforcojnë dyshimin objektiv se ka një diskriminim të papërligjur mbi bazën e gjendjes arsimore apo shoqërore.

Sa më lart, kërkoj zbulimin e të vërtetës materiale për të bërë të mundur të shpjegohet se pse është mbajtur kjo sjellje diferencuese ndaj meje dhe a përbën ky shkak një diskriminim.

Barra e provës për të vërtetuar këtë gjë, i takon autoriteteve policore. Prima facia, shoqërimi i të dy palëve, dhe fakti se të dy palët jemi aktorë të universitetit, njëri në cilësinë e pedagogut kurse tjetri në cilësinë e studentit dhe mbajtja në mënyrë diferencuese për këtë shkak, e përforcojnë këtë dyshim”.

Në vijim të shqyrtimit të çështjes, ankuesi me anë të e-mail-eve datë 01.11.2022 dhe datë 07.11.2022, ka kërkuar ndër të tjera: “...ndryshimin e shkakut të mbrojtur nga ai për shkak të gjendjes shoqërore dhe/ose arsimore në atë të “diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, e posaçërisht atë të shëndetit mendor apo psikik...subjektet ndaj të cilëve pretendoj diskriminim për shkakun e lartpërmendur, duke ngritur pretendimet vetëm ndaj: S. K., me detyrë Shef i Krimeve të Komisariatit nr. 2 të Tiranës, si dhe F. Ç. me detyrë Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Komisariatit nr. 2 të Tiranës...”.

Ndërsa me e-mail-in datë 03.01.2023, ankuesi ka kërkuar që të shtojë shkakun e diskriminimit, atë të gjendjes shoqërore/arsimore (pozitës).

Gjithashtu, ka sqaruar ndër të tjera se: “...shoqërimi im i detyrueshëm dhe kundër vullnetit në psikiatri është bërë nga Urgjenca Kombëtare. Policia shprehet se ata thjeshtë e kanë telefonuar këtë autoritet dhe më pas janë këta të fundit që kanë çmuar që i shoqëruari (unë) duhet të dërgohem në psikiatri. Kjo nuk është e vërtetë pasi ndaj meje nuk është bërë asnjë ekzaminim paraprak dhe as jam pyetur nga organi procedues nëse: unë kurohem, nëse marr ilaçe, nëse jam shtruar më përpara në ndonjë autoritet spitalor, nëse vuaj nga probleme depresive, etj.”

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1396/1 prot., datë 17.11.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë, që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Komisarati i Policisë Nr. 2, Tiranë, me shkresën³ Nr. 5883/1 prot., datë 24.11.2022, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “Në datën 08.09.2022 në mesditë shërbimet e Policisë Trup Shërbimi Patrulla e Përgjithshme, janë njoftuar nga salla operative e Drejtorisë së Policisë Tiranë që të shkojnë në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë në lidhje me një konflikt të ndodhur, ku një shtetas kërkonte ndihmën e Policisë. Në lidhje me informacionin e telefonuesit në Sallën Operative, Patrulla e Përgjithshme ka përpiluar një raport shërbimi i cili ndodhet në materialet e para procedurale dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë gjithashtu këtë fakt ato e kanë të pasqyruar dhe tek Formulari i Raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit.

Pasi kanë vlerësuar informacionin, punonjësit e policisë kanë shkuar në adresën e dhënë ku kanë marrë kontakt me shtetasin M. K., student i këtij Fakulteti dhe shtetasin K. M., pedagog i këtij Fakulteti dhe janë njohur mbi situatën e cila ka rezultuar se pedagogu K. M. gjendej në ambientin e zyrës së Zv. Dekanit, tek i cili kishte shkuar për ti adresuar problematikën e vazhdueshme dhe shqetësimet që po i sillte ky student. Gjithashtu, zv. Dekani i kishte ofruar për të qëndruar pedagogut me qëllim që të shmangej çfarëdo lloj kontakti me shtetasin M. K.

²Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

³ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 1396/2 prot., datë 24.11.2022

Për këtë rast është bërë shoqërimi në Komisariat i të dy palëve. Në momentin që këta shtetas kanë qenë në korridoret e Komisarariatit, shtetasi M. K. ka filluar duke ngritur zërin në mënyrë jo etike dhe formë presioni për punonjësit e policisë, si dhe ndaj pedagogut K. M., si dhe duke folur në mënyrë të pandalshme, të pa kuptimta. Ndërkohë është bërë shoqërimi i shtetasit M. K. në ambientet e dhomave të shoqërimit nga ana e punonjësve të policisë së patrullës së përgjithshme në orën 12:30 të datës 08.09.2022. Gjatë periudhës së shoqërimit ka shprehur se “do i bie murit me kokë”, “jam Jezusi”. U binte dyerve dhe fliste “përçart”. Këto fakte janë të pasqyruara edhe në librin e ngjarjeve në objekt (dinamika ditore).

Në këto kushte, punonjësi i policisë përgjegjës për informacionin në zbatim të nenit 114, paragrafi 2 të Ligjit “Për Policinë e Shtetit” Nr. 108/2014, si dhe Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit, kreu 7, pika 3, germa C, miratuar me urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019, ka njoftuar shërbimin shëndetësor nëpërmjet nr. 127.

Në lidhje me kohën e mbajtjes të shoqëruar në ambientet e policisë, kjo është e lejueshme deri në 10 orë sipas Ligjit për Policinë e Shtetit nr.108, viti 2014, neni 109.

Kjo kohë ka qenë e nevojshme për të kryer procedurat penale dhe identifikimin e personit të shoqëruar. Koha ka qenë nga ora 12.30 deri në 21.10, që përkon me 8 orë e 40 minuta, (përfshi këtu kohën e marrjes nga ambulanca për kontroll mjekësor).

Për rastin në fjalë janë bërë veprimet procedurale si: Kallëzimi dhe deklarimi i shtetasit K. M., i shoqëruar nga Dekani Fakultetit D. H., prej të cilit janë administruar: kopje të materialeve të publikuara në rrjete sociale, pamjet filmike të Fakultetit të Drejtësisë. Gjatë shpjegimeve të pedagogut ka përmendur se studenti M. K. (S.) ka probleme mendore (psikologjike). Problematika të kësaj natyre dhe të tjera janë të shpjeguara edhe në deklarime të mëvonshme.

Po kështu është pyetur dhe studenti M. S. në lidhje me rrethanat e ngjarjes, këtij shtetasi i është administruar një CD me pamjet filmike të dorëzuar prej tij.

Në lidhje me ngjarjen dhe të gjitha materialet procedurale janë referuar Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me shkresë Nr. 6557/k, datë 13.09.2022. Gjithashtu, janë dërguar materiale shtesë si: Praktika disiplinore e mbajtur nga Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë për studentin M. S. Deklarime shtesë të pedagogut K. M.

Në lidhje me dërgimin e shtetasit M. S. në ambientet e spitalit ky shtetas që në momentet e para të mbërritjes së patrullës në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë rezulton se gjendja psikologjike e lajmëruesit ka qenë mjaft e rënduar, i drejtohej pedagogut dhe policisë me një fjalor të papërshtatshëm, kërcënues dhe të pakuptimtë. Që në këto momente patrulla u bë dyshuese për gjendjen e këtij shtetasi.

Nga pedagogu K. M., jemi informuar se M. S. (K.) ka një gjendje psikologjike të paqëndrueshme, shpesh herë agresiv, jo vetëm me të por me të gjithë kolektivin e Fakultetit të Drejtësisë. Ai ngre pretendime nga më absurdet, komunikon me personelin akademik në mënyrë të papërshtatshme, me një gjuhë të ashpër, shpesh herë me nota shantazhuese dhe kërcënuese. Këto sjellje ky shtetas i ka manifestuar dhe gjatë shoqërimit dhe në ambientet e komisarariatit.

Në kushtet kur të shoqëruarit shfaqin probleme të shëndetit, Oficeri i informacionit përgjegjës edhe për personat e shoqëruar në Polici është i detyruar të njoftojë stafin mjekësor, dhe në rastin konkret ka njoftuar ambulancën nëpërmjet numrit 127. Ambulanca me stafin janë

paraqitur në Komisarlatin e Policisë Nr. 2 dhe Doktor pas mësosi shqetësimet për shtetasin M. S. duke e kontaktuar vetë atë, vendosën me mirëkuptim të shkonin në Spital për kontroll mjekësor. Më pas e kanë kthyer të shoqëruarin në Komisarlat ku duke shteruar procedurat është lënë i lirë.

Me të shoqëruarin kanë kryer veprime procedurale O.P.GJ. F. Ç., Nd. Specialisti Pol. Komunitet, E. V. dhe Patrulla e përgjithshme e turnit të dytë.

Proces verbali për veprimet me personin e shoqëruar është përpiluar nga punonjësi i policisë sipas rastit dhe pa asnjë lloj pretendimi të shfaqur për këtë fakt (i kundër firmosur nga i shoqëruari) dhe aq më tepër se e ka vet konfirmuar me shkrimin e tij se nuk ka pretendime, ankesa dhe kërkesa.

Sa i përket diskriminimit për shkaqe shëndetësore, ky pretendim nuk ekziston pasi vetë kuptimi i këtij paragrafi ka të bëjë me trajtimin ndryshe që i bëhet një personi dhe ky trajtim lidhet me gjendjen e tij shëndetësore. Në këtë kuptim do të ishte diskriminuese mos ofrimi në kohë i shërbimeve shëndetësore/mjekësore.”

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, me shkresën⁴ Nr. 1062 prot., datë 30.01.2023, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura nga subjekti ankues, ku mbajti të njëjtin qëndrim me parashtrimet e përcjella nga ana e Komisarlatit të Policisë Nr. 2, Tiranë, me shkresën Nr. 5883/1 prot., datë 24.11.2022.

2. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 24, datë 06.01.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 25.01.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi kopje e dokumentacionit, si më poshtë:

Nga ana e Komisarlatit të Policisë Nr. 2, Tiranë:

- Informacion dhe kopje të *Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit, miratuar me urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019*, në të cilat parashikohen hapat që ndiqen, rastet dhe arsyet që çojnë në shoqërimin e personave për kontroll mjekësor. A duhet marrë më parë një urdher nga ana e strukturave të prokurorisë apo Prokurorit të gatshëm?
- A disponohet informacion, sa i përket personit i cili ka telefonuar strukturat e Policisë së Shtetit për konfliktin e ndodhur më datë 08.09.2022, në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë Tiranë? Nëse po të vihet në dispozicion dokumentacion me anë të cilit të provohet fakti se cili është personi që ka njoftuar strukturat e Policisë së Shtetit për konfliktin e ndodhur më datë 08.09.2022, në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë Tiranë.

Nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë:

- A disponohet informacion, sa i përket personit i cili ka telefonuar strukturat e Policisë së Shtetit për konfliktin e ndodhur më datë 08.09.2022, në ambientet e Fakultetit të

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 187 prot., datë 01.02.2023.

Drejtësisë Tiranë? Nëse po të vihet në dispozicion dokumentacion me anë të të cilit të provohet fakti se cili është personi që ka njoftuar strukturat e Policisë së Shtetit për konfliktin e ndodhur më datë 08.09.2022, në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë Tiranë.

Nga ana e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore:

- Informacion mbi arsyet që M. K. (S.) është shoqëruar nga ana e stafit të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, pranë ambienteve të Shërbimit të Psikiatrisë të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. A është vendosur nga stafi mjekësor i Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, shoqërimi i ankuesit në ambientet e Shërbimit Psikiatrik, apo është udhëzuar nga ana e punonjësve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë?

Nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë:

- Informacion dhe kopje të ekzaminimit të bërë nga ana e stafit të Shërbimit të Psikiatrisë të QSUNT-së, lidhur me gjendjen shëndetësore të ankuesit, M. K. (S.).

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesi M. K. dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, F. Ç., me detyrë Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit nr. 2 të Tiranës, si dhe përfaqësuesit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, z. K. L. Ndërsa, palët e tjera nuk u paraqitën në seancë.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjektet i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në, të cilat do të shtjellohen në vijim.

Në vijim të seancës dëgjimore ankuesi theksoi sërish se nga ana e F. Ç. i është mohuar e drejta për të depozituar kallëzim apo kundër kallëzim ndaj pedagogut, K. M. Ky pretendim i tij, u mohua nga ana e F. Ç. si dhe sqarua se M. K. në asnjë moment nuk i kishte kërkuar të depozitojë kallëzim penal ndaj K. M. Kjo e mbështetur sipas tij edhe në Procesverbalin e mbajtur me ankuesin në momentin që ai është lënë i lirë dhe e ka nënshkruar atë, në të cilin ai nuk ka shprehur asnjë ankesë lidhur me sjelljen e punonjësve të policisë apo edhe me faktin që nuk i është marrë kallëzim.

Gjithashtu, ankuesi sqaroi se ka cituar si subjekt i cili pretendohet të ketë kryer sjellje diskriminuese edhe shtetasin S. K., me detyrë Shef i Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, për shkak se nga shkresa kthim përgjigje e vënë në dispozicion nga ana e Agjencisë për Mbikëqyrjen Policore, ka evidentuar se shoqërimi i tij drejt shërbimit psikiatrik është bërë me urdhër të S. K. Këtë informacion ankuesi theksoi se e ka marrë vetëm pasi ka paraqitur ankim pranë Agjencisë për Mbikëqyrjen Policore.

Pavarësisht faktit që nuk morën pjesë në seancën dëgjimore të datës 25.01.2023, në përgjigje të shkresës për zhvillimin e saj, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, me anë të shkresës⁵ nr. 19/1 prot., datë 10.01.2023, informoi ndër të tjera se: *“...Në orën 19:28 të datës 08.09.2022 në Njësinë e Koordinimit ka ardhur një thirrje nga numri +35569....., i cili është prezantuar si punonjës i Komisarariatit Nr. 2 dhe kërkonin një Autoambulancë për një person të ndodhur brenda ambienteve të komisarariatit. Menjëherë nga Njësia e Koordinimit është kryer aktivizimi i misionit dhe dërgimi i autoambulancës drejt rastit. Ekipi i aktivizuar dhe më afër me ngjarjen ka qenë ekipi TIR13 në përkatësi të Spitalit të Traumës dhe ekip mjekësor:*

- Mjek: Dr. S. B.
- Infermier: F. P.
- Shofer: P. R.

Nga komunikimi me ekipin mjekësor dhe njësinë e koordinimit informohemi që pacientin e kanë dërguar në spitalin psikiatrik, por nuk e kanë pranuar dhe po e ridërgonin në Komisariatin nr. 2... ”.

Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, vuri në dispozicion të Komisionerit skedën telefonike të printuar nga sistemi i integruar i të dhënave pranë Njesisë së Koordinimit të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, së bashku me audion e telefonatës së regjistruar (kopje në CD).

3. Pas seancës dëgjimore, me shkresën nr. 248 prot., datë 09.02.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga ana e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë, të vendos në dispozicion informacion shtesë⁶ lidhur me shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së M. K.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Komisarati i Policisë Nr. 2, Tiranë, me shkresën⁷ Nr. 759/1 prot., datë 21.02.2023, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Në lidhje me praktikat dhe raste të evidentuara nga ana e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, mbi personat që janë dërguar për kontroll mjekësor/ekzaminim në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” apo*

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 24/1 prot., datë 13.01.2023

⁶ - Kopje të: Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit, miratuar me urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019, dhe Procedurës standarde të punës për “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset policore, miratuar me urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

- Informacion nëse ka patur raste të tjera, ku personat e shoqëruar pranë ambienteve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë, janë dërguar për kontroll mjekësor/ekzaminim në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” apo Shërbimin e Psikiatrisë ? Nëse po, të vihet në dispozicion numri i rasteve për periudhën 2020-aktualisht dhe arsyet e shoqërimit të tyre.

- Informacion, nëse ka patur kamera në ambientet e dhomave të shoqërimit, ku është mbajtur i shoqëruar ankuesi? Nëse po, të vihen në dispozicion pamjet filmike.

- Kopje të akteve të referuara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën Nr. 6557/k, datë 13.09.2022.

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 248/5 prot., datë 22.02.2023

Shërbimet e Psikiatrisë, ju informojmë se për këto procedura nuk mbahet ndonjë regjistër për evidentimin e tyre por ndiqet rast pas rasti në përputhje me ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” si dhe “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit, miratuar me urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019”. Gjithashtu nga verifikimet e bëra rezulton se shtetasi M. S. më datën 08.09.2022 është shoqëruar në ambientet e dhomave të shoqërimit të monitoruara me kamera të cilat administrohen nga Komisariati i Policisë Nr. 2 Tiranë. Përsa i përket vënies në dispozicion të pamjeve filmike ju informojmë se Hard Disku i Kamerave që monitoron ambientet e Komisarariatit Nr. 2, mban një memorie prej 30 ditë, për këtë arsye është e pamundur vënia në dispozicion e pamjeve filmike të datës 08.09.2022.”

Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, Komisariati i Policisë Nr. 2, Tiranë, vuri në dispozicion të Komisionerit Procedurën standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit, miratuar me urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019”, si dhe një kopje të shkresës dërguar Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën⁸ Nr. 624/3 prot., datë 07.03.2023, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura nga subjekti ankues, ku mbajti të njëjtin qëndrim me parashtrimet e përcjella nga ana e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë, me shkresën Nr. 759/1 prot., datë 21.02.2023.

4. Me shkresën nr. 248/1 prot., datë 10.02.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të vendos në dispozicion lidhur me shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së M. K., materialet procedurale të cilat janë referuar nga ana e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën⁹ Nr. 2168/1 prot., datë 17.02.2023, vuri në dispozicion të Komisionerit kopjen e njësuar me origjinalin për “Mos fillimin e procedimit penal” Nr. 12284, viti 2022.

5. Me shkresën nr. 248/2 prot., datë 10.02.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga ana e Avokatit të Popullit, të vendos në dispozicion informacion dhe kopje të akteve të administruara gjatë trajtimit të ankesës së M. K., si dhe rekomandimin drejtuar Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Avokati i Popullit, me shkresën¹⁰ Nr. K2/M15-10 prot., datë 16.02.2023, vuri në dispozicion të Komisionerit kopjen e informacionit të kërkuar lidhur me trajtimit të ankesës së M. K., si dhe rekomandimin drejtuar Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë.

⁸ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 248/6 prot., datë 09.03.2023

⁹ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 248/4 prot., datë 22.02.2023

¹⁰ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 248/4 prot., datë 22.02.2023

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkuftizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohej diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose*

procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b¹¹, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfutur të mira apo shërbime dhe më konkretisht në lidhje me shoqërimin në ambientet e Komisariatin e Policisë Nr. 2, Tiranë.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

- i. *Sa i përket shoqërimit të ankuesit në ambientet e Komisariatin e Policisë Nr. 2, Tiranë dhe në Shërbimin Psikiatrik të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.*

Subjekti ankues në datën 08.09.2022, rreth orës 11:00, ka pasur një konflikt verbal me K. M., pedagog i lëndës së të Drejtës Penale të Posaçme në Fakultetin e Drejtësisë Tiranë. Pas konfliktit M. K. ka njoftuar nëpërmjet telefonit shërbimet e Policisë së Shtetit, të cilat kanë mbërritur pranë Fakultetit të Drejtësisë. Sapo punonjësit e Policisë së Shtetit janë paraqitur në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë kanë marrë kontakt me M. K., i cili i ka sqaruar lidhur me konfliktin mes tij dhe K. M.

¹¹ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: “Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët në proces, pedagogu K. M. gjendej në ambientin e zyrës së Zv. Dekanit, tek i cili kishte shkuar për ti adresuar problematikën e vazhdueshme dhe shqetësimet që po i sillte ky student. Pasi punonjësit e patrullës së Policisë së Shtetit janë vënë në dijeni të konfliktit nga palët dhe faktin që zgjidhja e tij nuk bëhej me mirëkuptim, kanë bërë shoqërimin e tyre në Komisariatin e Policisë Nr. 2 Tiranë. Referuar informacionit të cituar në Raport-Shërbimin e përpiluar nga punonjësit e policisë (Autopatrulla 53/09), datë 08.09.2023, mes palëve kishte vijuar konflikti verbal edhe në prani të tyre.

Referuar informacionit të cituar në Formularin e Raportit të Shoqërimit ose Ndalim/Arrestimit, të plotësuar nga ana e Patrullës së Përgjithshme të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, nga ana e ankuesit është kërkuar zgjidhja e konfliktit me K. M. në ambientet e Komisariatit të Policisë Nr. 2, pasi ai e ka fyer dhe ka tentuar ta godasë.

Mbështetur në situatën e krijuar, Patrulla e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka bërë shoqërimin e palëve në ambientet e Komisariatit të Policisë Nr. 2 në përputhje me nenin 6, pika 25 dhe nenin 109 të ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se:

Neni 6, *“Përkufizime”*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“...25. “Shoqërimi” është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji”.

Neni 109, *Shoqërimi në polici*

1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:

- a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;*
- b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;*
- c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer vepër penale;*
- ç) për të parandaluar kryerjen e një veprë penale;*
- d) kur është larguar pas kryerjes së një veprë penale;*
- dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;*
- e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent;*
- ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;*
- f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.*

2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.

3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për

shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.

4. Efektivi i policisë njofton menjëherë qendrën operative për gjeneralitetet e personit të shoqëruar, kur ato njihen, orën e saktë të shoqërimit dhe shkaqet e tij. Të dhënat e komunikuar nga efektivi i policisë hidhen menjëherë në sistemin elektronik të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave. Mosrespektimi nga efektivi i policisë i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

5. Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

6. Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë eprorin e vet ose institucionin e interesuar për sqarimin e çështjes. Të dhënat e veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dokumentohen gjithashtu në regjistrat/librat që mbahen për këtë qëllim në ambientet e policisë ku është bërë shoqërimi i personit.

7. Për rastet e shoqërimit për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimin ose ekstradimin, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

8. Rregullat teknike të shoqërimit, evidentimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar në ambientet e policisë përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Gjithashtu, në zbatim të ligjit të sipërcituar, në Kreun III të Procedurave standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, parashikohet se: “Shoqërimi” është veprimi administrativ, me karakter detyrues (me ose pa vullnetin e personit që shoqërohet) dhe shtrëngues (qoftë edhe forcërisht), që kryhet nga punonjësi i policisë për dërgimin e shtetasit në ambientet e policisë apo në institucionet e tjera, sipas përcaktimeve dhe procedurave të parashikuara me ligj e aktet nënligjore”. Ndërsa në kreu V, D/4, ku citohen Rastet dhe Qëllimet e Aplikimit të Shoqërimit, parashikohet se: “...për sqarimin e një rrethane:

4.1. Të personit për të cilin ka dyshime të arsyeshme se ka kryer vepër penale;

4.2. Për të parandaluar kryerjen e një vepre penale;

4.3. Personi është larguar pas kryerjes së një vepre penale;

4.4. Personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;...”

Sa i përket shoqërimit në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë, ankuesi nuk ka ngritur asnjë pretendim rreth këtij veprimi apo sjelljes së punonjësve të Patrullës së Përgjithshme me të.

Në momentin që palët janë paraqitur në ambientet e Komisarariatit, sipas informacionit të dhënë, ankuesi ka nisur të debatojë në mënyrë jo etike me punonjësit e policisë, si dhe me K. M. Për këtë arsye, ankuesi është shoqëruar në ambientet e dhomave të shoqërimit nga ana e punonjësve të policisë së Patrullës së Përgjithshme. Referuar Regjistratit të Evidentimit të të Dhënave për

Personat e Shoqëruar, rezulton se ankuesi është shoqëruar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, në orën 12:30 të datës 08.09.2022.

Mbështetur në Librin e Ngjarjeve në Objekt, gjatë periudhës së shoqërimit është evidentuar se ankuesi, u binte dyerve dhe fliste “përçart”. Në këtë moment, rezulton që nga ana e punonjësve të policisë, me miratimin e eprorëve, është njoftuar Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore. Sipas informacionit të përcjell nga ana e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore me shkresën Nr. 19/1 prot., datë 10.01.2023, në orën 19:28 të datës 08.09.2022, është njoftuar Njësia e Koordinimit nga një punonjës i Komisarariatit Nr. 2 dhe ka kërkuar një Autoambulancë për një person të ndodhur brenda ambienteve të komisarariatit. Referuar audios së vënë në dispozicion nga ana e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, evidentohet se një punonjës i policisë së Komisarariatit të Policisë Nr. 2, ka njoftuar përmes telefonit Njësinë e Koordinimit të Urgjencës Mjekësore dhe ka kërkuar një autoambulancë pranë ambienteve të Komisarariatit, për shkak se një person i shoqëruar nuk ndihej mirë.

Menjëherë nga Njësia e Koordinimit është dërguar autoambulanca drejt Komisarariatit të Policisë Nr. 2, e cila ka mbërritur në orën 19:40 dhe në 19:50 është nisur drejt Shërbimit Psikiatrik pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. Ekipi i autoambulancës, sipas informacionit të administruar ka qenë i përbërë nga stafi mjekësor: 1 (një) mjek, 1 (një) infermier dhe shoferi i autoambulancës.

Nga regjistrimi audio¹² dhe provat e administruara, ankuesi është shoqëruar në ambientet e Shërbimit Psikiatrik të QSUNT-së, në praninë e punonjësve të policisë dhe të stafit mjekësor. Pas mbërritjes në orën 20:00 dhe konsultës së zhvilluar në Shërbimin Psikiatrik, në orën 20:20, autoambulanca është nisur për ta ridërguar në Komisariatin e Policisë Nr. 2, për shkak se ankuesi nuk ishte rast për tu trajtuar nga ana e këtij shërbimi.

Mbështetur në informacionin e administruar, njoftimi i shërbimit mjekësor dhe shoqërimi i ankuesit drejt Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, është bërë në zbatim të nenit 114, të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, i cili përcakton se kontrolli mjekësor i personit: *“1. Me vendim gjykate, për të parandaluar kërcënimin për jetën, personit mund t’i bëhet kontroll mjekësor, t’i merren kampione të gjakut ose të kryhen ndërhyrje të tjera në trup nga një mjek. Kontrolli mjekësor i personit kryhet në përputhje me rregullat mjekësore për qëllime ekzaminimi, lejohet pa miratimin e personit, nëse kjo nuk dëmton shëndetin e tij dhe masa vlerësohet e nevojshme nga mjeku.*

2. Në raste të kërcënimit të menjëhershëm, punonjësi i policisë, me nismën e tij, dërgon personin në institucionin përkatës mjekësor.

3. Të dhënat e mbledhura gjatë kontrollit përdoren vetëm për qëllimin e këtij neni.”.

¹² Vënë në dispozicion nga ana e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore me shkresën Nr. 19/1 prot., datë 10.01.2023

Në zbatim të nenit 114, të sipërcituar, si dhe referuar informacionit¹³ të dhënë nga palët, Procedura standarde e punës për “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në kreun VI, pika 3/b dhe c, parashikojnë se: “

...b) Kur vlerësohet se personi i shoqëruar ka nevojë për përkujdes mjekësor merren masat e nevojshme për dhënien e ndihmës mjekësore si dhe kur është e domosdoshme, dërgohet për trajtim në qendrat spitalore të qytetit, rrethit apo ato rajonale;

c) Personat që vuajnë nga sëmundje apo janë me çrregullime të shëndetit mendor dhe gjendja e tyre shoqërohet me sjellje agresive patologjike ose seriozisht të pa përgjegjshme që mund të shkaktojnë dëmim të vetë personit, personave të tjerë, ambientit përreth, etj shoqërohen në ambientet e institucioneve shëndetësore për dhënien e ndihmës dhe trajtimin përkatës të specializuar”.

Përsa më lart, vërehet se pas sjelljes së shfaqur nga ankuesi në dhomat e shoqërimit, cituar edhe në Librin e Ngjarjeve në Objekt, në referim të akteve ligjore dhe nënligjore përsa më sipër, strukturat e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë, kanë marrë masat e nevojshme për dhënien e ndihmës mjekësore dhe trajtimin përkatës të specializuar, duke e dërguar në ambientet e institucioneve shëndetësore për dhënien e ndihmës, pas vlerësimit nga stafi mjekësor i autoambulancës së Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.

Në kuptim përsa më sipërcituar, si dhe nga provat e administruara, evidentohet se ankuesi dhe K. M.me të cilin ai ishte në konflikt, në mbështetje të akteve ligjore dhe nën ligjore janë shoqëruar nga Patrulla e Policisë drejt Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë për sqarimin e rrethanave të ngjarjes. Asnjë nga palët e shoqëruara nuk provohet se ka shprehur kundërshti apo të ketë ngritur pretendime lidhur me shoqërimin në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2.

Referuar situatës së krijuar dhe dokumentacionit të mbajtur nga ana e strukturave të policisë së Komisarariatit të Policisë Nr. 2, ankuesi është shoqëruar drejt Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, nga strukturat përgjegjëse mjekësore në ambientet e Shërbimit Psikiatrik. Nga provat e administruara, nuk rezulton në asnjë moment, se nga ana e punonjësve të policisë të jetë udhëzuar apo rekomanduar shoqërimi i ankuesit në Shërbimin Psikiatrik, por shoqërimi i tij është bërë nga ana e strukturave përgjegjëse të stafit mjekësor të autoambulancës së Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.

Në përfundim, pavarësisht faktit që ankuesi pretendon se pedagogu K. M., ka informuar se ai ka një gjendje psikologjike të paqëndrueshme, nuk rezulton që shoqërimi i tij në ambientet e Shërbimit Psikiatrik të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, është bërë referuar udhëzimeve të K. M. apo me urdhër të S. K., me detyrë Shef i Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë. Pra, shoqërimi i ankuesit në Shërbimin Psikiatrik, është bërë nga ana e strukturave përgjegjëse të stafit mjekësor të autoambulancës së Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.

¹³ Referuar informacionit të dhënë gjatë seancës dëgjimore

- ii. *Sa i përket kohës së mbajtjes të shoqëruar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë.*

Referuar provave të administruara, ankuesi është shoqëruar nga ana e Patrullës së Përgjithshme në Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, në orën 12:30 të datës 08.09.2022. Nga këqyrja e Regjistrimit të Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar, ankuesi është lënë i lirë në orën 21:10. Pra, koha e qëndrimit të tij pranë ambienteve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, përkon me 8 orë e 40 minuta, (përfshi këtu kohën e marrjes nga ambulanca për kontroll mjekësor).

Neni 109, pika 2 e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, parashikon se: “...2. *Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë....*”

Nga përmbajtja e pikës 2 të nenit 109 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, kuptohet që koha e mbajtjes në gjendje shoqërimi të një personi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes dhe jo më shumë se 10 orë.

Në zbatim të nenit 109, të sipërcituar, Procedura standarde e punës për “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në kreun V “Përgjegjësitë e punonjësit të policisë në rastet e shoqërimit dhe zbatimi i afateve”, parashikohet se: “

1. *Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikojë masën e shoqërimit dhe mbajë në mjediset e policisë një person për aq kohë sa është e domosdoshme për identifikimin apo sqarimin e rrethanave në ngarkim të tij, por jo më shumë se 10 orë.*

2. *Afati 10 orësh është kufiri maksimal kohor i mbajtjes së një personi. Në rast se verifikimet e nevojshme (identifikimi dhe sqarimi i rrethanave) përfundojnë në një kohë më të shkurtër se sa është afati maksimal, oficerit të policisë i paraqiten dy mundësi:*

a. *Të lirojë menjëherë të shoqëruarin;*

b. *Të kryej ndalimin/arrestimin e tij, në bazë të nenit 253/2 dhe nenit 251/3 të Kodit të Procedurës Penale;*

3. *Kur qëllimi i masës së shoqërimit është realizuar brenda një afati kohorë më të shkurtër dhe punonjësi i policisë që ka kryer procedurat e verifikimit vazhdon ta mbajë personin, me arsyetimin se nuk është plotësuar afati 10 orë, do konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe mund të ndiqet penalisht në bazë të nenit 250 të K. Penal (Kryerja e veprimeve arbitrare).*

4. *Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë sallën e komandimit dhe eprorin e tij ose institucionin e interesuar për rastin e shoqërimit. Drejtuesi i strukturës policore, nëse çmon se shoqërimi nuk është i mbështetur në ligj, urdhëron menjëherë lirimin e të shoqëruarit.*

5. *Të drejtën për të vendosur lirin e personit të shoqëruar, pasi janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme, e ka oficeri i policisë që kryen procedurat e verifikimit të çështjes, i cili plotëson dokumentacionin përkatës dhe njofton eprorin e tij për masën e lirit të personit... ”.*

Nga informacioni i administruar dhe aktet e vëna në dispozicion, ankuesi është mbajtur në gjendje shoqërimi brenda afatit kohor prej 10 orësh të parashikuar nga dispozitat e sipërcituara. Referuar provave të administruara, nuk konstatohet koha kur strukturat e policisë kanë përfunduar verifikimet e nevojshme për çështjen në fjalë. Megjithatë, Komisioneri vëren se ankuesi është mbajtur i shoqëruar brenda kufirit kohor të mbajtjes së një personi. Gjithashtu, nga procesverbali për veprimet me personin e shoqëruar, që është përpiluar nga punonjësi i policisë dhe është firmosur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, F. Ç., ankuesi me shkrimin e tij ka cituar se nuk ka pretendime, ankesa dhe kërkesa.

Pra, sa më lart, nuk u konstatua se ankuesi është mbajtur i shoqëruar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2 përtej afatit kohor të përcaktuar nga aktet ligjore apo nënligjore të sipërcituar.

iii. *Sa i përket mosmarrjes së kallëzimit nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore, F. Ç.*

Nga ana e ankuesit në ankesë është pretenduar se Oficeri i Policisë Gjyqësore, F. Ç., i ka mohuar të drejtën për të depozituar kallëzim apo kundër kallëzim ndaj pedagogut, K. M. Një fakt i tillë është mohuar nga ana e F. Ç. gjatë seancës dëgjimore, duke u sqaruar se M. K. në asnjë moment nuk i kishte kërkuar të depozitojë kallëzim penal ndaj K. M. Nga ana e F. Ç., rezulton se ankuesit i janë marrë shpjegime (deklarime) lidhur me konfliktin e ndodhur.

Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon në nenet 283 dhe 284, si më poshtë:

“283. Kallëzimi nga ana e shtetasve:

- 1. Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.*
- 2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.*
- 3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.*

284. Ankimi:

- 1. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 84, 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 148, 149, 243, 254, 264, 275, 290 paragrafi i parë dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e viktimës, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit.*
- 2. Ankimi bëhet nga viktimë te prokurori ose në policinë gjyqësore me anën e një deklarate, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqet vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale.*

3. Kur ankimi bëhet me gojë procesverballi që mbahet për këtë qëllim nënshkruhet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij.
4. Ai që merr ankimin sigurohet për identitetin e ankuesit dhe i dërgon aktet prokurorit.
5. Për rastet e parashikuara nga neni 59, ankimi bëhet në gjykatë nga viktimat akuzuese.”

Nga deklaratimet e bëra gjatë seancës dëgjimore nga palët dhe informacioni i paraqitur, Komisioneri nuk arriti të administrojë prova të mjaftueshme dhe konstatojë nëse ankuesi i ka kërkuar F. Ç., të paraqesë ankim/kallëzim ndaj shtetasit, K. M. Gjithashtu, nuk rezulton që ankuesi të ketë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të paraqitur ankim në ditët në vijim apo edhe në organet e tjera të ngarkuara me ligj për marrjen e kallëzimit për veprat penale. Gjithashtu, evidentohet se në momentin që ankuesi është lënë i lirë dhe ka dalë nga ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë, ka nënshkruar në Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar si dhe në Procesverbalin e veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar. Nga këqyrja e këtyre dy dokumenteve, rezulton se ankuesi i ka nënshkruar me shkrim dore se nuk ka paraqitur pretendime, as sa i përket mosmarrjes së kallëzimit nga ana e F. Ç., si dhe as ndonjë nga pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e subjekteve ndaj të cilave është paraqitur ankesa nuk ka patur veprime të padrejta, të pafavorshme apo të paligjshme kundrejt ankuesit, përse ai ka pretenduar. Nga analiza e akteve të sipërcituara dhe provave të administruara, rezultoi se:

- Shoqërimi i ankuesit në ambientet e Shërbimit Psikiatrik të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, nuk është bërë referuar udhëzimeve të K. M. apo me urdhër të S. K., siç pretendon ankuesi, por pas vlerësimit nga ana e strukturave përgjegjëse të stafit mjekësor të autoambulancës së Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore;
- Ankuesi është mbajtur i shoqëruar brenda kufirit kohor të mbajtjes së një personi në gjendje shoqërimi prej 10 orësh konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore të cituara më sipër në vendim;
- Nuk u arritën të administrohen prova të mjaftueshme dhe konstatohet nëse ankuesi i ka kërkuar F. Ç., të paraqes ankim/kallëzim ndaj shtetasit, K. M. Gjithashtu, nuk rezulton se ankuesi të ketë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të paraqitur ankim në ditët në vijim apo edhe në organet e tjera të ngarkuara me ligj për marrjen e kallëzimit për veprat penale.
- Nuk u arrit të provohej se S. K., me detyrë Shef i Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, ka urdhëruar shoqërimin e ankuesit në ambientet e Shërbimit Psikiatrik të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, për shkak të udhëzimeve të K. M.;
- Në momentin që ankuesi është lënë i lirë dhe ka dalë nga ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, Tiranë, ka nënshkruar në Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar si dhe në Procesverbalin e veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar. Nga këqyrja e këtyre dy dokumenteve, rezulton se ankuesi i ka nënshkruar me shkrim dore se nuk ka paraqitur pretendime, as sa i përket mosmarrjes së kallëzimit nga ana e F. Ç., si dhe as ndonjë nga pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*.

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e S. K., me detyrë Shef i Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, si dhe F. Ç. me detyrë Oficer i Policisë Gjyqsore pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri, arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e subjekteve ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, kundrejt ankuesit, për shkaqet e pretenduara prej tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, M. K., për shkaqet e pretenduara prej tij, nga ana e S. K., me detyrë Shef i Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, si dhe F. Ç. me detyrë Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Komisariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, në fushën e të mirave dhe shërbimeve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shëndetësore dhe gjendjes arsimore/pozita)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)